



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:032152

Datë: 21.08.2024

Numri i dokumentit: 06072285

P.nr.41/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, bashkëpunëtores profesionale Vesa Bajrami, në çështjen penale ndaj të pandehurve F. L. nga Gj., A. M. nga fsh. P. K. Gj., L. M. nga fsh. P. K. Gj. dhe T. K. nga Gj., të cilët i akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.3176/22 të dt.27.01.2023, për shkak të veprës penale në bashkryerje Vjedhja nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar, publik, të mbajtur me datën 20.08.2024, në prani të pandehurve dhe në mungesë të dëmtuarit, në të njejtën ditë, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurve:

1.F. L., nga i ati S. dhe e ëma M., e gjinisë M., i lindur me ... në Gj., me vendbanim në rrugën "M.", nr.. Gj., i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.A. M., nga i ati S. dhe e ëma N., e gjinisë K., i lindur me ... në Gj., me vendbanim në fshatin P. K. Gj., i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

3.L. M., nga i ati S. dhe e ëma N., e gjinisë K., i lindur me ... në Gj., me vendbanim në fshatin Pasjak K. Gjilan, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

4.T. K., nga i ati N. dhe e ëma K., e gjinisë A., i lindur me ... në Gj., me vendbanim në rrugën "Xh. M.", te "P. K." Gj., i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, me nr. personal .., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 29.03.2022, rreth orës 00:53, në rrugën "R. T.", nr....., në fshatin G. e U. K. L., saktësisht para lokalit "G. C.", të pandehurit F. L., A. M., L. M., R. A., T. K. dhe me të miturin A. D., në bashkëryerje, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj, kanë vjedhur motorin e tipit K. N. ... i cili ishte në defekt e i parkuar para hyrjes së lokalit me ç'rast të dëmtuarit G. T. i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material,

-me këtë në bashkëryerje kanë kryer veprën penale Vjedhje nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69 dhe nenit 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurve u shqipton:

DËNIM ME GJOBË DHE ME KUSHT

Të pandehurit të parë **F. L.** dënim me gjobë në shumë prej 500-€ (pesëqindeuro), të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€, dhe

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 viti nuk do të kryej asnjë vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

Të pandehurit të dytë **A. M.** dënim me gjobë në shumë prej 500-€ (pesëqindeuro), të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€, dhe

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 viti nuk do të kryej asnjë vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

Të pandehurit të tretë **L. M.** dënim me gjobë në shumë prej 500-€ (pesëqindeuro), të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€, dhe

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 viti nuk do të kryej asnjë vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

Të pandehurit të katërt **T. K.** dënim me gjobë në shumë prej 500-€ (pesëqindeuro), të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€, dhe

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 viti nuk do të kryej asnjë vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

DETYROHEN të pandehurit secili veç e veç që në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajnë paushallin gjyqësor secili veç e veç nga 30-€, si dhe shumën nga 20-€, në Fondin për Kompensimin e Viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

I dëmtuari: G. T. nga fsh. G. e U. K.L. udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.3176/22 të dt.27.01.2023, i ka akuzuar të pandehurit F. L. nga Gj., A. M. nga fsh. P. K. Gj., L. M. nga fsh. P. K. Gj. dhe R. A. nga Gj. dhe T. K. nga Gj., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhje nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Ndaj te pandehurit R. A. ne mungesë të tij me aktvendimin proceduralë te dt.20.08.2024 është veçuar procedura përarsye te ekonomizimit te procedurës.

I pandehuri i parë F. L. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale, është shprehur i penduar dhe ka kërkuar nga gjykata që t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.

I pandehuri i dytë A. M. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e ndien vetën fajtor dhe është shprehur shumë i penduar, ka shtuar se është baba i dy fëmijëve, është i gjendjes jo të mirë ekonomike, i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë sjellje të tilla dhe e ka lutur gjykatën që t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.

I pandehuri i tretë L. M. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e ndien vetën fajtor dhe është shprehur shumë i penduar, është i gjendjes jo të mirë ekonomike, gjykatës i ka premtuar që në të ardhmen nuk do të përsërisë sjellje të tilla dhe e ka lutur gjykatën që t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.

I pandehuri i katërt T. K. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se se e ndien vetën fajtor dhe ndihet i penduar për bashkëpunimin me të bashkëpandehurit e tjerë dhe për sjelljet që i ka bërë më parë. Gjykatës i ka premtuar që në të ardhmen nuk do të përsërisë sjellje të tilla dhe e ka lutur gjykatën që të i shqiptoj një dënim sa më të butë sepse do ta mbaj premtimin që të silltet si qytetar i ndershëm.

Prokurori i shteti në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve pasi që një pranim i tillë gjenë mbështetje në provat personale dhe materiale të bashkangjitura në aktakuzë, andaj ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj pranimin e fajësisë ku me rastin e caktimit të dënimit të merr parasyshtë rrethanat lehtësuese dhe rënduese nga neni 70 par.2 pika 2.2 shkallën e lartë të dashjes ndërsa nga par.3 pika 3.10 pranimin e fajësisë dhe 3.11 keqardhjen e shfaqur nga të pandehurit.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pranimi i fajësisë nuk është rezultat i përdorimit të forcës apo premtimeve të kundërligjshme, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkelje të qarta ligjore e as gabime faktike, konform nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve për veprën penale për të cilën akuzohen.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin F. L., gjykata pati parasyshtë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese vlerësoi rrethanat personale dhe familjare pra faktin se i njëjti është i moshës së re dhe ka gjasa që në të ardhmen të bëhet anëtarë i dobishëm i shoqërisë, faktin se i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike dhe sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veçanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi gjykata vlerësoj sjelljen e të pandehurit para kryerjes së veprës penale pra faktin se edhe më parë ka pasur sjellje jo të mira (e gjykuar për raste të ngjajshme) dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me gjobë konform nenit 38 dhe 47 të KPRK-së.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin A. M., gjykata pati parasyshtë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe familjare pra faktin se i njëjti është i martuar, është mbajtës i familjes dhe i ka 2 fëmijë, është i gjendjes jo të mirë ekonomike dhe sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veçanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi gjykata vlerësoj sjelljen e të pandehurit para kryerjes së veprës penale pra faktin se edhe më parë ka pasur sjellje jo të mira (e gjykuar për raste të ngjajshme) dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke

qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me gjobë konform nenit 38 dhe 47 të KPRK-së.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin L. M., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese vlerësoi rrethanat personale dhe familjare pra faktin se i njëjti është i moshës së re dhe ka gjasa që në të ardhmen të bëhet anëtarë i dobishëm i shoqërisë, faktin se i njëjti është i gjendjes jo të mirë ekonomike dhe sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veçanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi gjykata vlerësoj sjelljen e të pandehurit para kryerjes së veprës penale pra faktin se edhe më parë ka pasur sjellje jo të mira (e gjykuar për raste të ngjajshme) dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me gjobë konform nenit 38 dhe 47 të KPRK-së.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin T. K., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe familjare pra faktin se se i njëjti është i moshës së re dhe ka gjasa që në të ardhmen të bëhet anëtarë i dobishëm i shoqërisë, faktin se i njëjti është i gjendjes jo të mirë ekonomike dhe sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veçanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi gjykata vlerësoj sjelljen e të pandehurit para kryerjes së veprës penale pra faktin se edhe më parë ka pasur sjellje jo të mira (e gjykuar për raste të ngjajshme) dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me gjobë konform nenit 38 dhe 47 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, për paushall gjyqësor shuma prej 30-€, ndërsa shuma prej 20-€, u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike u bazua në nenin 462 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN

P.nr.41/23 dt.20.08.2024

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 ditë nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate

Numri i lëndës: 2023:032152
Datë: 21.08.2024
Numri i dokumentit: 06072285